



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 501/8 Prot.

Tiranë, më 4.11.2024

**V E N D I M**

**PARALAJMËRIMI**

Nr. 62, datë 4.11.2024

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 4040 prot., datë 22.7.2024, të eprorit direkt, për moskonfirmimin si nëpunës civil në përfundim të periudhës së provës të nëpunësit \*\*\*\*\*.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe, Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Drejtësisë,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet shkresave të regjistruara me nr. 501 prot., datë 06.9.2024; nr. 501/2 prot., datë 17.09.2024; nr.501/5 prot., datë 02.10.2024; dhe nr. 501/6 prot., datë 02.10.2024, nëpunësi civil në periudhë prove \*\*\*\*\* , ka informuar Komisionerin, duke pretenduar për disa parregullsi të kryera ose të lejuara nga zyrtarët vlerësues dhe eprori direkt, gjatë aplikimit të institutit të periudhës së provës, e konkretisht në kryerjen e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë për këtë periudhë, duke sjellë si pasojë moskonfirmimin e tij si nëpunës civil.

Nga hetimi administrativ i kryer në këtë rast dhe pas analizës së dokumentacionit të çështjes, të administruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 501/4 prot., datë 1.10.2024, dërguar nga Ministria e Drejtësisë, rezulton e vërtetuar se, me aktin nr. 3764 prot., datë 17.7.2023, të Departamentit të Administratës Publike, kandidati \*\*\*\*\* është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “Specialist në Sektorin e Monitorimit të Rrjetit Antikorrupsion”, në Drejtorinë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, në Drejtorinë e

Përgjithshme të Antikorrupsionit, në Ministrinë e Drejtësisë. Më pas, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë ka nxjerrë aktin *nr. 4586/1 prot., datë 20.7.2023*, për fillimin e efekteve financiare të kandidatit të emëruar nga njësia përgjegjëse, duke filluar nga data 21.7.2023.

Më tej, në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në pikën 2, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se nëpunësi \*\*\*\*\* ka ndjekur ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s dhe në testimin e zhvilluar në datën 20.3.2024, ka marrë 28 pikë, të cilat janë edhe pikët maksimale gjatë këtij vlerësimi.

Pra, nëpunësi e ka kryer me sukses trajnimin e detyrueshëm duke marrë 100% të pikëve në testim. (Në pikën 2, kreu IV, të VKM nr. 138, datë 12.3.2014, “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, trajnimin e nëpunësve civilë, si dhe të çdo individi tjetër jashtë shërbimit civi”, i ndryshuar, trajnimi konsiderohet i ndjekur me sukses nëse nëpunësi merr të paktën 50% të pikëve në testim).

Në zbatim të procedurave, Drejtori i Përgjithshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, me shkresën nr.4586/2 prot., datë 20.7.2023, ka caktuar nëpunësin civil më të vjetër, nën kujdesin e të cilit do të vendosej nëpunësi në periudhë prove dhe në përfundim të saj, nëpunësi mbikëqyrës në datën 19.7.2024, nëpërmjet një shkrese, ka dhënë mendimin e tij për nëpunësin \*\*\*\*\*.

Duke analizuar këtë shkresë si nga pikëpamja formale ashtu edhe materiale, vërehet se ajo nuk është hartuar sipas standarteve të miratuara për shkresat zyrtare, pasi ajo nuk ka në krye figurën e stemës së Republikës, shkrimin “Republika e Shqipërisë”, ministrinë përkatëse, si dhe emërtimin e strukturës të cilës i drejtohet/adresohet. Gjithashtu, shkresa nuk i është përcjellë eprorit direkt nëpërmjet zyrës së arkiv protokollit pasi nuk rezulton e regjistruar në librin e dorëzimit të brendshëm të dokumentacionit.

Ndërsa, lidhur me përmbajtjen e këtij akti rezulton se, nëpunësi mbikëqyrës vetëm ka renditur detyrat kryesore të nëpunësit në periudhë provë dhe si konkluzion ka pohuar se punonjësi i ka drejtuar shpeshherë pyetje teorike lidhur me punën.

Në përmbajtjen e kësaj shkrese nuk evidentohet asnjë informacion lidhur me performancën që ka treguar nëpunësi në provë, aftësitë e tij për t’u përshtatur me kolegët dhe eprorët, si dhe nuk është dhënë një gjykim se si ka ndikuar përvoja e nëpunësit në provë në mbarëvajtjen e drejtorisë.

Në këto kushte, vlerësojmë se, mendimi me shkrim i nëpunësit mbikëqyrës, si një nga 3 elementet bazë ku duhet të bazohet eprori në momentin e konfirmimit të nëpunësit në periudhë prove, nuk përmban ndonjë informacion për t’u marrë si bazë në vendimmarrjen e tij, për mënyrën se si duhet të përmbillet kjo fazë e periudhës së provës.

Ndërkohë, në lidhje me përmbajtjen e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë në kuadër të periudhës së provës në drejtim të verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave dhe aftësive apo dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, si një element tjetër thelbësor

në trajtimin e periudhës së provës, në zbatim të përcaktimeve të pikës 4, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; germës b), pika 6, të kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar dhe germës b), pika 1, të kreut II, të vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, konstatohet se, nëpunësit \*\*\*\*\*\*, për periudhën e provës, është vlerësuar me dy vlerësime të pjesshme dhe konkretisht:

- Vlerësim i pjesshëm i datës 29.2.2024, që përfshin periudhën 26.7.2023 - 29.2.2024 (ndërkohë që rezultoi se nëpunësi ka filluar marrëdhëniet financiare me institucionin në datën 21.07.2023) dhe është vlerësuar në nivelin “jokënaqshëm” (4). Në këtë rast, edhe pse është vlerësim i pjesshëm, nëpunësi ka kërkuar rivlerësim, por edhe pas rivlerësimit, vlerësimi ka mbetur i pandryshuar.
- Vlerësim i pjesshëm i datës 21.7.2024, periudha e vlerësimit 1.3.2024 - 21.7.2024, dhe është vlerësuar në nivelin “jokënaqshëm” (4). Edhe në këtë rast, nëpunësi ka kërkuar rivlerësim, pas të cilit, vlerësimi ka mbetur përsëri i pandryshuar.

Sa më sipër, rezultoi se për nëpunësin civil në periudhë prove, në këtë rast ka dy vlerësime të pjesshme dhe procesi nuk është finalizuar me një vlerësim përfundimtar, në fund të periudhës së vlerësimit, në një formular të vetëm vlerësimi, ashtu si parashikohet në ligj, për periudhën që nis nga data 21.07.2023, që përkon me fillimin e marrëdhënieve financiare të nëpunësit me institucionin dhe që përfundon në datën 21.7.2024.

Pas vlerësimit përfundimtar, për të gjithë vitin e periudhës së provës, nëpunësit civil i lind e drejta për tu ankuar, për aktin e vlerësimit të punës, nëse ai nuk është dakord me vlerësimin përfundimtar.

Po kështu, edhe e drejta e eprorit për të finalizuar procesin e konfirmimit të nëpunësit civil, i lind atëherë kur procesi i vlerësimit ka përfunduar në përputhje me ligjin, duke respektuar të drejtat e nëpunësit civil për tu ankuar nëse nuk është dakord me vlerësimin.

Në këtë rast, sjellim në vëmendje detyrat e Zyrtarit raportues dhe të Njesisë së burimeve njerëzore, në përputhje me pikën 6 dhe 7, të Kreut III, “Detyrat e Nëpunësve të Përfshirë në Procesin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë”, të VKM-së nr. 109 datë 26.02.20214, i ndryshuar, ku parashikohet se nëpunësi në rolin e Zyrtarit raportues ka detyrimin ligjor të bëjë vlerësimin për nëpunësin/nëpunësit që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën hierarkike, për të gjithë periudhën e ushtrimit të këtij funksioni.

Në rast se, Zyrtari raportues largohet apo ndodhet në pamundësi të vazhdimin të mëtejshëm të detyrës, ai ka detyrimin ligjor të bëjë vlerësimin për nëpunësit nën hierarkinë e tij, për periudhën gjatë së cilës ka ushtruar detyrën. Ky vlerësim do të shërbejë si bazë nga zyrtari zëvendësues në vlerësimin e tij përfundimtar, i cili është një vlerësim i përmbledhur i suksesit të nëpunësit dhe duhet të përfshijë të gjithë periudhën e vlerësimit, duke përpiluar për këtë qëllim edhe një formular të vetëm vlerësimi të rezultateve në punë për punonjësin.

Më konkretisht këto dispozita parashikojnë si më poshtë:

(pika 6) *“... Në rast se gjatë periudhës së vlerësimit, zyrtarët që duhet të bëjnë vlerësimin largohen nga ai pozicion apo ndodhen në pamundësi të vazhdimit të detyrës, ata janë të detyruar të bëjnë vlerësimin për nëpunësin/nëpunësit për periudhën gjatë së cilës kanë ushtruar detyrën.*

(pika 7) *Vlerësimi sipas pikës 6 të këtij kreu, merret si bazë nga zyrtari zëvendësues në vlerësimin e tij përfundimtar”.*

Në rastin e kryerjes së vlerësimit të pjesshëm për shkak të largimit nga detyra, zyrtari që realizon vlerësimin e pjesshëm (i cili siç e arsyetuar është “Zyrtari raportues” dhe ai është përgjegjës për plotësimin e të gjitha ndarjeve A, B, C, Ç e D të formularit të vlerësimit), në ndarjen A, në rubrikën “Periudha e vlerësimit” do të shënojë periudhën gjatë së cilës ai ka ushtruar detyrën, në rubrikën “Lutemi shënoni sipas rastit: Vlerësim vjetor i rezultateve në punë - Rishikim i ndërmjetëm - Tjetër (Specifiko)”, do të plotësohet rasti “Tjetër (Specifiko)” ku do të përcaktohet qartë “Vlerësim i rezultateve në punë për periudhën (periudha që zyrtari ka ushtruar detyrën) për shkak të largimit të nëpunësit (emër/mbiemër), nga pozicioni (emërtesa e pozicionit).

Më tej, zyrtari/zyrtarët që largohen, vlerësimin e pjesshëm e dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore, e cila më pas i vë në dispozicion të zyrtarit, i cili do të veprojë si zëvendësues i zyrtarit të larguar.

Dhe në përfundim të këtij procesi, Zyrtari që është në detyrë në fund të periudhës do të bëjë vlerësimin përfundimtar të nëpunësit për gjithë periudhën 1 vjeçare të vlerësimit duke marrë parasysh të gjitha vlerësimet e pjesshme.

Pra, për sa analizuam më sipër, nga ana e zyrtarit raportues, në rastin konkret është vepruar në kundërshtim me ligjin. Dy vlerësimet që janë kryer për nëpunësin në fjalë, duhet të konsiderohen si vlerësime të pjesëshme nga ana e zyrtarit raportues, i cili ka qenë në detyrë në momentin që do të kryhej vlerësimi përfundimtar i nëpunësit në fjalë dhe do të shërbenin si bazë për vlerësimin e tij, në një formular vlerësimi në përfundim të periudhës së provës.

Ndërkohë, nga dokumentacioni i administruar rezulton se, në kushtet kur nuk ka një vlerësim përfundimtar për gjithë periudhën e provës, eprori direkt në datën 21.7.2024 ka nënshkruar vlerësimin e pjesshëm dhe më pas, ditën e nesërme, në datën 22.7.2024, me nxitim ka nxjerrë vendimin nr. 4040 prot., datë 22.7.2024, për moskonfirmimin e nëpunësit \*\*\*\*\* si “nëpunës civil” në pozicionin “Specialist në Sektorin e Monitorimit të Rrjetit Antikorrupsion”, në Drejtorinë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, duke vendosur si arsyetim: “bazuar në rezultatet e dobëta në punë, të cilat janë reflektuar në vlerësimin individual të punës”.

Duke analizuar përmbajtjen e aktit të konfirmimit konstatohet se nuk janë marrë parasysh të tre komponentët që janë përcaktuar në nenin 24 të ligjit për nëpunësin civil, ndër të cilët,

përveç vlerësimit të punës, përfshihen edhe rezultatet e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s dhe mendimi i nëpunësit me të vjetër.

Më tej, vendimi i është dërguar për njoftim nëpunësit \*\*\*\*\* dhe për dijeni njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dhe njësisë përgjegjëse DAP. Me vendimin nr. 27 (nr.4040/1 prot.), datë 30.7.2024, të Drejtorit të Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, është vendosur lirimi nga shërbimi civil i nëpunësit në provë, për shkak të moskonfirmimit si nëpunës civil, duke përcaktuar ndërprerjen e marrëdhënieve financiare në datën 30.7.2024.

Për më tepër, nga verifikimi i komunikimit me e-mail, ndërmjet nëpunësit \*\*\*\*\* njësisë së burimeve njerëzore dhe zyrtarëve të vlerësimit, konstatohet se, edhe kopja e vlerësimit të pjesshëm, për periudhën e vlerësimit 1.3.2024 - 21.7.2024, i është njoftuar nëpunësit nga zyra e burimeve njerëzore në datën 23.7.2024, në të cilën edhe është nënshkruar prej tij, pra **1 (një) ditë pas datës** në të cilën ka dalë vendimi i moskonfirmimit si nëpunës civil (data 22.7.2024).

Në këto rrethana, duke pasur parasysh rregullin ligjor të përcaktuar në pikën 2, të kreut II, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se, vlerësimi i rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës është vjetor dhe llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil në detyrë, vlerësohet se në rastin në fjalë, nga ana e zyrtarëve vlerësues nuk janë respektuar përcaktimet e kësaj dispozite për shkak se nuk është bërë një vlerësim i përmbledhur apo përfundimtar për gjithë periudhën e provës, por janë bërë dy vlerësime të pjesshme. Për më tepër, vlerësimi i periudhës së fundit të vitit të vlerësimit, procedura nuk është finalizuar, pasi në përfundim të procedurës së rivlerësimit nga Zyrtari Autorizues, i formularit të vlerësimit për periudhën 1.3.2024 - 21.7.2024, (kryer në datën 25.7.2024), ky akt nuk i është vënë në dispozicion nëpunësit të vlerësuar, për ta nënshkruar atë, me qëllim finalizimin e procesit dhe më tej respektimin e të drejtës së nëpunësit për t’u ankuar në rast se nuk është dakord me vlerësimin e punës.

Nga ana tjetër, referuar dokumentacionit të administruar, konstatohet se nuk janë evidentuar materiale shkresore (shënime, procesverbale, etj.), të cilat të provojnë realizimin nga ana e zyrtarit raportues të bisedimeve të ndërmjetme dhe takimeve të rregullta me nëpunësin që vlerësohet, detyra këto të parashikuara në germën b), pika 12, kreu II dhe germat ç) e d), kreu III, të aktit nënligjor (VKM nr. 109, datë. 26.2.2014). Legjislacioni përcakton se bisedimet/takimet e realizuara zyrtari raportues duhet të mbajë shënime ku i bën të qartë nëpunësit arsyet se përse mbarëvajtja e tij në punë konsiderohet e dobët, si dhe veprimet që do të ndërmeren për përmirësimin e situatës. Shënimet pasqyrohen në hapësirën/nënndarjen “Komentet e zyrtarit raportues/Shpjegime”, me qëllim që vlerësimi i nëpunësit të jetë i arsyetuar, i argumentuar dhe objektiv, ç’ka nuk rezulton të jetë kryer në këtë rast.

Po kështu, nëse pretendohet për ecuri të dobët të nëpunësit, gjatë veprimtarisë së tij, atëherë aktet që e provojnë atë, duhet të jenë të administruara si pjesë e procesit të vlerësimit, ç’ka nuk provohet në këtë rast.

Në formularin e vlerësimit, rezulton se, nënndarja “*Komentet e zyrtarit raportues/Shpjegime*”, është plotësuar me një fjali përgjithësuese, ashtu si është e shprehur në përmbajtjen e formularit tip të vlerësimit, që është pjesë e aktit nënligjor që rregullon këtë institut të ligjit. Ndërkohë, procedura dhe përmbajtja e ligjit, kërkojnë që në rubrikën e komenteve duhet të konkretizohet rasti dhe ato duhet të plotësohen në mënyrë të zgjeruar dhe shteruese për të nxjerrë në pah anët negative/pozitive të punës së nëpunësit civil.

Për më tepër, në dosjen e vlerësimit, duhet të jetë i administruar i gjithë materiali provues për të argumentuar vlerësimin jo mjaftueshëm që është aplikuar për nëpunësin në fjalë, në të gjitha rubrikat e formularit të vlerësimit, ç’ka nuk vërtetohet të ketë ndodhur në këtë rast.

Duke analizuar ç’ka u evidentua më sipër, konstatohet se një nga elementët më të rëndësishëm për të finalizuar periudhën e provës, është vlerësimi i punës që materializohet në formularin e vlerësimit të punës, akt i cili në këtë rast nuk është plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit si në formë ashtu edhe në përmbajtjen e tij. Për pasojë, nëpunësi nuk ka mundur të ushtrojë të drejtën e ankimit për këtë fazë të procesit të periudhës së provës.

Komisioneri vlerëson se nga ana e subjekteve që janë ngarkuar prej ligjit me detyra të caktuara të administrimit të shërbimit civil nuk janë respektuar ato, e për pasojë ndodhemi përpara një procesi administrativ të kryer në kundërshtim me procedurën dhe kërkesat e ligjit. Kjo situatë duhet të rregullohet në përputhje me kërkesat e ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; akteve nënligjore që e rregullojnë atë si edhe në nenet 109 dhe 113, të ligjit nr.44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, duke vepruar sipas dispozitave të këtij vendimi paralajmërues.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; të germës d), të nenit 109 dhe 113, të ligjit nr.44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

#### **VENDOSA:**

Të paralajmëroj institucionin e Ministrisë së Drejtësisë, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Të përsëritet procesi i vlerësimit të punës për nëpunësin \*\*\*\*\*\*, për gjithë periudhën e provës, duke respektuar kërkesat e ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore për zbatim të tij, ashtu sikur është evidentuar në vendim, nga ana e zyrtarëve të ngarkuar me këtë proces, që janë eprori direkt dhe zyrtarët vlerësues.

2. Njësia përgjegjëse duhet të marrë masat për njoftimin e zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit, në lidhje me detyrimin për përsëritjen e procesit të vlerësimit, duke respektuar të gjithë normat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë institut të ligjit për nëpunësin civil.
3. Të anulohet akti nr. 4040/1 prot., datë 30.7.2024, për lirimin nga shërbimi civil, i nëpunësit \*\*\*\*\*, nga organi që e ka nxjerrë atë, si një akt që ka dalë në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në ligj, duke rregulluar edhe pasojat e ardhura.
4. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat 15 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Të njoftohet për këtë vendim Ministria e Drejtësisë, Departamenti i Administratës Publike, si dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**